

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L

**Për: Komp. Rajon Ujësjellës "Hidromorava" SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                  |                       |
|------------------|-----------------------|
| Nr1 i prokurimit | nuk ka-26-4560-5-2-1" |
|------------------|-----------------------|

Titulli: **Zgjerimi I rrjetit të ujësjellësit dhe kuçjet individuale në lagjen Fidanishte II të Gjilanit**

**GOE:**

"KUSHTRIMI NM" SH.P.K, "COMPANY MURSELI" SH.P.K. & "ALPING" SH.P.K"  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Terpeze Viti

(Adresa)

**Viti**

(Vendi)

(61000)

**044 143 103**

(Numri Telefonit)

**N/A**

(Numri i Faks-it)

**Naser Misini**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**kushtriminm@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**20.07.2026**

(Nënshkrimi dhe vula)



## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë: 10.06.2026  
Data e procesverbalit të hapjes: 22.06.2026  
Njoftimi mbi vendimin e AK: 25.06.2026  
Kërkesa për rishqyrtim: 30.06.2026  
Vendimi i Ri-vlersimit 03.07.2026  
Kërkesë për rishqyrtim: 07.07.2026  
Vendimi në kërkesën për rishqyrtim: 08.07.2026  
Ankesa në OSHP: 20.07.2026

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1  
Neni 6  
Neni 7  
Neni 27  
Neni 51  
Neni 59

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

AK/Komisioni i vlerësimit me date 08.07.2026 e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se nuk janë paraqitur prova të reja. Një arsyetim i tillë nuk ka bazë në Ligjin për Prokurimin Publik. Procedura e rishqyrtimit nuk kushtëzohet me paraqitjen e provave të reja, por me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe të pretendimeve të OE. AK ka shmangur trajtimin e argumenteve juridike të paraqitura nga ne dhe është mjaftuar me përsëritjen e konstatimeve të vendimit paraprak.

Me date 03.07.2026 përmes platformës elektronike dhe emailit jemi njoftuar se ne si Grup i Operatoreve Ekonomik "KUSHTRIMI NM" SH.P.K, "COMPANY MURSELI" SH.P.K. & "ALPING" SH.P.K" jemi eliminuar pas Rivlersimit të dytë nga ana juaj edhe pse jemi të përgjegjshëm me çmimin me të lirë dhe JU keni rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm me çmimin me të lartë OE Hidro Project SH.P.K.

Ne vijim të kësaj ankese do të paraqesim në mënyrë të qartë dhe të argumentuar për pretendimet tona

**Pretendimi 1.** Arsyeja e eliminimit tonë nga AK shikohet arsyetimin:!!..

*Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye* Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të procesit të vlerësimit në aktivitetin e prokurimit në fjalë, ju njoftojmë se oferta juaj është eliminuar nga procedura e mëtejshme e vlerësimit për arsyet e mëposhtme:

Në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, respektivisht të Kapaciteti Teknik dhe Profesional, është kërkuar që Operatori Ekonomik të angazhojë 1 (një) Menaxher të Projektit – Master i diplomuar i Ndërtimtarisë (Hidroteknikë) me së paku 3 (tre) vite përvojë pune. Po ashtu, është kërkuar që për këtë person të dorëzohet vendimi për emërim, diploma, licenca e kategorisë A, kontrata e punës ose parakontrata për angazhim në këtë projekt, CV-ja dhe referencat e punës.

ALPING SH.P.K I cili është antare i Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka emëruar z. Arben Hajrizi në pozitën e Menaxherit të Projektit. Mirëpo, nga kontrata e punës e nënshkruar ndërmjet palëve konstatohet se në nenin 6 të saj është përcaktuar se: "I punësuarit themelon marrëdhënie pune me orar të plotë. Orari i punës gjatë ditës është 4 (katër) orë pune në ditë, përkatesisht 20 (njëzet) orë pune në javë."

Ky përcaktim paraqet një kundërtënie në vetvete, pasi kontrata fillimisht e cilëson marrëdhënien e punës si me orar të plotë, ndërsa menjëherë më pas specifikon një angazhim prej vetëm 4 orësh në ditë, respektivisht 20 orësh në javë, që sipas legjislacionit të punës konsiderohet orar jo i plotë.

Duke marrë parasysh natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me punime ndërtimore në terren, Menaxheri i Projektit paraqet personin kyç përgjegjës për organizimin, koordinimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e përditshëm të punimeve. Për realizimin e suksesshëm të kontratës, prania e tij në

<sup>1</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përzgjedhshëm dhe të rrezikshëm.

kantier duhet të jetë e vazhdueshme gjatë orarit të punës, në mënyrë që të sigurohet drejtimi profesional i punimeve, koordinimi me mbikëqyrësin e kontratës, zgjidhja e çështjeve teknike që paraqiten gjatë ekzekutimit dhe garantimi i cilësisë së punimeve.

Një angazhim prej vetëm 4 orësh në ditë nuk garanton disponueshmërinë e nevojshme të Menaxherit të Projektit për të përmbushur përgjegjësitë që rrjedhin nga realizimi i kësaj kontrate. Përkundrazi, duke qenë se punimet në terren zhvillohen përgjatë gjithë orarit të punës, Menaxheri i Projektit duhet të jetë i angazhuar gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të punimeve, respektivisht së paku 8 orë në ditë, në përputhje me dinamikën e punimeve dhe nevojat operative të projektit.

Për rrjedhojë, kontrata e paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk dëshmon angazhimin e plotë të Menaxherit të Projektit për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk ofron garanci se ai do të jetë në dispozicion gjatë gjithë orarit të punës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen efektive të punimeve, siç kërkohet nga natyra dhe rëndësia e projektit.

Pra kërkesa e AK ka qenë shumë e qartë: **Operatori ekonomike duhet të angazhojë staf profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme** a) 1 (Një) Menaxher të projektit - MASTER i dip.i ndërtimtarisë ( hidroteknike)- 3 vite përvojë pune.

**Dëshmi 3 a. Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit. Menaxheri duhet të posedojë Diplomën dhe Licencën kategoria A për këtë projekt, të ketë kontratën e punës të nënshkruar nga të dy palet si dhe e vulosur nga punëdhësi, ose parakontartë ku specifikohet qartë angazhimin në këtë projekt e nënshkruar nga të dy palet dhe e vulosur nga punëdhësi, CV-ja, referencat e punës.**

Autoriteti Kontraktues gjatë procesit të rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim të plotë me Dosjen e Tenderit dhe Ligjin për Prokurimin Publik, duke eliminuar Grupin e Operatorëve Ekonomikë mbi baza të paqena, përmes interpretimeve arbitrare dhe vendosjes së kriterëve të reja të cilat nuk janë paraparë në dokumentacionin e tenderit. Një veprim i tillë cenon rëndë parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

Pra Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar mungesë të asnjë dokumenti të kërkuar në Dosjen e Tenderit. Përkundrazi, të gjitha dokumentet janë dorëzuar në përputhje të plotë me kërkesat. Eliminimi është mbështetur ekskluzivisht në interpretime subjektive dhe jo në kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Një praktikë e tillë është e papranueshme dhe përbën tejkalim të kompetencave të komisionit të vlerësimit.

### 1. Menaxheri i Projektit

Kërkesa e Dosjes së Tenderit është shumë e qartë. AK ka kërkuar:

- 1 Menaxher Projektit – Master i Ndërtimtarisë (Hidroteknikë);

- Minimum 3 vite përvojë pune;
- Vendim për emërim;
- Diplomë;
- Licencë Kategoria A;
- Kontratë pune ose parakontratë ku specifikohet angazhimi në projekt;
- CV;
- Referenca pune.

Askund në këtë kriter nuk kërkohet që Menaxheri të jetë i punësuar me orar të plotë 8 orë në ditë.

Prandaj, AK gjatë rivlerësimit ka futur një kriter të ri që nuk ekziston në Dosjen e Tenderit.

Kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e parimeve të prokurimit publik, sepse:

- Nuk lejohet ndryshimi i kriterëve pas hapjes së ofertave;
- Nuk lejohet interpretimi i kriterëve në mënyrë restriktive;
- Nuk lejohet eliminimi mbi baza që nuk janë kërkuar në DT.

Madje, nga dokumentet që ne kemi dorëzuar rezulton se z. Arben Hajrizi posedon përvojë shumë më të madhe sesa minimumi i kërkuar. CV-ja e tij dëshmon një eksperiencë shumëvjeçare në projektim, menaxhim projektesh, ujësjellës, kanalizime dhe hidroteknikë, me angazhime në institucione publike, organizata ndërkombëtare dhe kompani private.

**PRA:**

I vetmi pretendim është se kontrata është 4 orë.

Por ky nuk ka qenë kriter.

**Prandaj arsyeja e eliminimit është e SHPIKUR gjatë fazës së RI-vlerësimit nga ana AK-së.**

**Prandaj kete pike te eliminimit eshte plotesisht e pa bazuar nga AK.**

**Z. Arben Hajrizi plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.**

Përvoja e tij profesionale tejkalon ndjeshëm kërkesën minimale prej 3 viteve dhe dëshmohet përmes dokumentacionit të dorëzuar.

Qëllimi i kriterit të stafit profesional është të sigurohet që projekti të menaxhohet nga një person kompetent dhe i licencuar. Ky qëllim është përmbushur plotësisht.

Fakti që kontrata e punës është me kohë të pjesshme nuk e cenon aftësinë profesionale, licencimin apo angazhimin e tij në projekt, veçanërisht kur Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim të tillë.

Eliminimi i ofertës sonë është bërë mbi një bazë e cila nuk ekziston në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues ka zëvendësuar kriteret e publikuara me një interpretim të ri gjatë fazës së rivlerësimit, duke cenuar parimet themelore të prokurimit publik.

**Pretendimi nr 2.** Arsyeja e eliminimit tone nga AK shikoh arsyetimin:!!.



Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të procesit të vlerësimit në aktivitetin e prokurimit në fjalë, ju njoftojmë se oferta juaj është eliminuar nga procedura e mëtejshme e vlerësimit për arsyet e mëposhtme: Në Dosjen e Tenderit, respektivisht të Kërkesës 3, është kërkuar që Operatori Ekonomik të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e projektit, sipas listës së pajisjeve dhe mekanizimit të obligueshëm të përcaktuar në Aneksin 7. Gjithashtu, te Dëshmia 3 është kërkuar që Operatori Ekonomik të paraqesë listën e makinerive në posedim ose të ofrojë dëshmi për shfrytëzimin e tyre nëpërmjet kontratës së bashkëpunimit ose kontratës për dhënie në shfrytëzim. Për automjetet dhe pajisjet është kërkuar dorëzimi i deklaratave unike doganore, faturave të blerjes ose librezave të qarkullimit, ndërsa në rastet kur pajisjet shfrytëzohen në bazë të marrëveshjes, është kërkuar edhe kopja e marrëveshjes për shfrytëzim.

Në Aneksin 7, te kërkesat minimale për llojin e mekanizimit dhe pajisjeve, në pikën 10 është kërkuar posedimi ose sigurimi i pajisjes: "Makinë për shpime horizontale me sistem kontrolli me laser me dimensione DN 110 mm deri DN 550 mm." Grupi i Operatorëve Ekonomikë "KUSHTRIMI NM" SH.P.K., "Murseli" SH.P.K. dhe "ALPING" ka dorëzuar kontratë për dhënie në shfrytëzim të kësaj pajisjeje ndërmjet "KUSHTRIMI NM" SH.P.K. dhe "KOM GROUP" SH.P.K.

Megjithatë, nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se pajisja e ofruar është e përshkruar si:  
"Makinë e përdorur për shpime gjeotermale, shpime për puse, shpime horizontale me sistem laserik të kontrollit; Marka: Comacchio, Tipi: MC900P; Orë pune: 4200; Total: 1 copë."

Komisioni i vlerësimit ka konstatuar se dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon se pajisja e paraqitur i përmbush specifikimet minimale të kërkuara në Dosjen e Tenderit, përkatësisht nuk dëshmohet se makina është e destinuar dhe e aftë për realizimin e shpimeve horizontale me dimensione DN 110 mm deri DN 550 mm, ashtu siç është kërkuar në Aneksin 7. Përshkrimi i pajisjes në dokumentacion nuk përmban të dhëna teknike që vërtetojnë përmbushjen e këtij kriteri, ndërsa fakti që pajisja mund të përdoret edhe për shpime horizontale nuk është i mjaftueshëm për të provuar se ajo i plotëson dimensionet dhe karakteristikat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.



**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT**

**"Hidromorava" SH.A**

**REGIONAL COMPANY FOR WATER**

Për rrjedhojë, Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e Kërkesës 3 dhe Dëshmisë 3 të Dosjes së Tenderit, lidhur me posedimin ose sigurimin e pajisjes së kërkuar sipas Aneksit 7, dhe oferta e tij është vlerësuar si e papërgjegjshme.

Pra kërkesa ka qenë shume e qartë: Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas sipas listës dt7. Dëshmi 3 OE duhet që të prezantoj listën e makinerive në posedim apo të ofroj dëshmi bashkëpunimi me ndonjë kompani tjetër përmes kontratës për shfrytëzim, Deklarata unike doganore ose kontrata fatura e blerjes per automjetet qe nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit per automjetet qe regjistrohen .Ne rastet kur OE ka marrveshje per shfrytezim , OE duhet te dorezoj edhe kopjen e marrveshjes per shfrytëzim.

### **Lidhur me pretendimin 2 te Autoritetit Kontraktues për makinën e shpimeve horizontale**

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me mosplotësimin e kërkesës për pajisjen e shpimeve horizontale është tërësisht i pabazuar në fakte, në dokumentacionin e ofertës dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka dorëzuar dokumentacion zyrtar, i cili dëshmon qartë ekzistencën dhe karakteristikat e pajisjes së ofruar. Në Dokumentin Unik Doganor përshkrimi i pajisjes është i qartë dhe i pakontestueshëm: **"Makinë e përdorur për shpime gjeotermale, shpime për puse, shpime horizontale me sistem laserik të kontrollit, Marka Comacchio, Tipi MC900P."**

Ky dokument është dokument zyrtar i lëshuar nga autoritetet doganore dhe gëzon prezumimin e ligjshmërisë dhe saktësisë derisa të provohet e kundërta.

Megjithatë, në vend që ta vlerësojë këtë dokument sipas përmbajtjes së tij, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur ta injorojë përmbajtjen e dokumentit dhe ta zëvendësojë atë me një interpretim personal, duke pretenduar se makina paskësh qenë vetëm për shpime gjeotermale dhe puse.

Një arsyetim i tillë është juridikisht i papranueshëm.

Në asnjë pjesë të Ligjit për Prokurimin Publik nuk i njihet Autoritetit Kontraktues kompetenca që, pa asnjë ekspertizë teknike dhe pa asnjë provë objektive, të rrëzojë përmbajtjen e një dokumenti zyrtar dhe ta zëvendësojë atë me bindjen subjektive të Komisionit të Vlerësimit.

Edhe më e rëndësishme është se vetë Dokumenti Doganor e përshkruan shprehimisht pajisjen si **makinë për shpime horizontale**, çka rrëzon në tërësi pretendimin e Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, është e pakuptueshme se mbi çfarë baze faktike apo juridike AK ka arritur në përfundimin se pajisja nuk plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë provë materiale që dëshmon se makina nuk mund të realizojë shpime horizontale.

Në mungesë të këtyre provave, konkluzioni i AK-së mbetet vetëm një supozim subjektiv, i cili nuk mund të prodhojë pasoja juridike ndaj operatorit ekonomik.

Edhe sikur Autoriteti Kontraktues të kishte dyshime lidhur me karakteristikat teknike të pajisjes, ai nuk kishte të drejtë të ndërtonte vendimin mbi hamendësime. Barra e provës i takon Autoritetit Kontraktues. Një vendim administrativ nuk mund të mbështetet në perceptime personale, por vetëm në prova objektive dhe të verifikueshme.

Për më tepër, Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar që pajisja të jetë prodhuar ekskluzivisht për shpime horizontale. Kërkesa ka qenë që operatori ekonomik të disponojë makinë për realizimin e shpimeve horizontale. Dokumentacioni ynë dëshmon pikërisht këtë fakt.

Është praktikë e njohur në industrinë e ndërtimit dhe inxhinierisë civile që makinat shumëfunksionale të prodhuesve ndërkombëtarë, përfshirë modelin **Comacchio MC900P**, përdoren për shpime gjeotermale, puse, mikropilota dhe shpime horizontale, varësisht konfigurimit dhe pajisjeve ndihmëse. **Prandaj, pretendimi i AK-së se përshkrimi "gjeotermale" përjashton funksionin e shpimeve horizontale nuk ka asnjë bazë teknike apo profesionale.**

Si rrjedhojë, eliminimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë mbi këtë bazë përbën një veprim arbitrar, disproporcional dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv të ofertave.

Pra AK nuk ka arritur të provojë se dokumentacioni ynë është i pasaktë; përkundrazi, ka zgjedhur ta shpërfillë një dokument zyrtar dhe ta zëvendësojë atë me një interpretim subjektiv, duke cenuar rëndë ligjshmërinë e procesit të vlerësimit. Për këtë arsye, ky konstatim duhet të shpallet i pabazuar dhe të hiqet nga arsyetimi i vendimit, ndërsa oferta jonë duhet të rivlerësohet në përputhje me kriteret e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

**Prandaj edhe ky pretendim i AK-se është i pa bazuar.**

|                                                          |                                                                                                                                                                              |                                    |                                             |                                                                                                              |
|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 29 Zyra doganore hyrëse/dalëse<br>2035 HANI ELEZIT TRAKA |                                                                                                                                                                              | 30 Lokacioni i mallrave            |                                             |                                                                                                              |
| 31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit                      | Shenjat dhe numrat - Nr i kontenerit - Numri dhe lloji<br>Shenja & nr Nr serik:1239;Viti i prodhimit:2008;<br>Kontener<br>Numri dhe 1 NG<br>Lloji Pa paketim<br>Vetëlëvizëse |                                    | 32 Artikull<br>1 No                         | 33 Numri tarifor<br>84304100 00                                                                              |
|                                                          | Makinë e përdorur shpimi geotermale, shpime për puse, shpime horizontale me sistem laserik të kontrollit; Marka:Comacchio, Tipi:MC900P; Orë pune:4200; Total: 1 cp           |                                    | 34 Kodi origjinës<br>a IT b                 | 35 Peshë bruto (kg)<br>16,000.00                                                                             |
|                                                          |                                                                                                                                                                              |                                    | 37 Procedura<br>4000 000                    | 38 Peshë Neto (kg)<br>16,000.00                                                                              |
|                                                          |                                                                                                                                                                              |                                    | 40 Dokumenti paraprak/dok. përmbledhës<br>1 | 39 Kuota<br>S/L                                                                                              |
|                                                          |                                                                                                                                                                              |                                    | 41 Njesia plotësuese                        | 42 Çmimi për njësi<br>51,500.00                                                                              |
|                                                          |                                                                                                                                                                              |                                    | 43 M.V.<br>1                                | 44 Inf. Dokument Certifikata dhe Autorizime<br>Nr. Licencës 2,500.00+1,720.00+0.00+488.00-0.00<br>D. 380 934 |
|                                                          |                                                                                                                                                                              | Kodi I.S.H. 45 Rregullimi<br>1.000 |                                             |                                                                                                              |
|                                                          |                                                                                                                                                                              | 46 Vlera Statistikore<br>56 208 00 |                                             |                                                                                                              |

### **Pretendimi 3.**

*Madje dhe për fund si OE ju RIKUJTOJM juve si AK ku jeni kapur tek makineria e shpimit e cila është adekuat për shpime vertikale dhe horizontale ashtu siq e kemi ofruar dudin doganore dhe sipas kërkesës së DT, ndërsa keni rekomanduar për kontratë kompanin e cila nuk ka ofruar deshmin sipas DT po ka ofruar një fotorgafi për kamionin të ciles në libereze i shkruan Kamion i Lehte ku kërkesa ishte “Kamion kiper” madje e kanë cilsuar sikur se plotëson këto kriter por në fakt i njëjti është i papërgjegjshëm shiko me poshtë pretendimin e radhës.*

*Shih me poshtë makinën në fjalë!*

**Pretendimi 3.** OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk plotëson dosjen e tenderit edhe tek pajisjet e kërkuar në aneksin 7 makineria me nr.1 -Kamion kiper deri në 5 ton.



OE i rekomanduar per kontrate, ka ofruar nje kamion - 1x Kamion kiper- qe nuk ploteson dosjen e tenderit, pasi qe ne librezë nuk e deshmon qe eshte kamion kiper, pershkrimi eshte : **Kamion i lehte Shiko deshmin.**



Pretendimi ynë lidhur me OE Hidro Projekt ShPK është plotësisht i bazuar dhe është mbështetur në dokumentacionin zyrtar të dorëzuar nga vetë operatori ekonomik.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në dosjen e tenderit që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e një **kamioni kiper me peshë bartëse deri në 5 ton.**

OE Hidro Projekt ShPK, përmes marrëveshjes së shfrytëzimit me OE Ndërtimi ING ShPK, ka dorëzuar librezën e automjetit. Megjithatë, nga kjo librezë nuk rezulton se automjeti është i regjistruar si **kamion kiper**, por si **kamion i lehtë (Ford Transit 2.5 TD).**

Fotografitë e bashkëngjitura nuk mund të zëvendësojnë dokumentin zyrtar të regjistrimit të automjetit. Vlerësimi i përmbushjes së kërkesave të dosjes së tenderit duhet të mbështetet në dokumentacionin zyrtar dhe jo në fotografi, të cilat nuk provojnë klasifikimin teknik apo karakteristikat e regjistruara të automjetit.

Për më tepër, vetë fakti që është bashkëngjitur fotografi e një automjeti me kiperin lartë, ndërkohë që librezë nuk e identifikon atë si kamion kiper, krijon mospërputhje ndërmjet dokumentacionit zyrtar dhe provave të paraqitura. Në procedurat e prokurimit publik, çdo paqartësi ose mospërputhje lidhur me përmbushjen e kërkesave teknike duhet të interpretohet në dritën e dokumenteve zyrtare dhe jo të supozimeve.

Prandaj, OE Hidro Projekt ShPK nuk ka dëshmuar në mënyrën e kërkuar nga dosja e tenderit se posedon ose ka në dispozicion një **kamion kiper me peshë bartëse deri në 5 ton**, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për rrjedhojë, oferta e tij nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe është dashur të shpallet e papërgjegjshme.

Veçanërisht shqetësues është fakti se Autoriteti Kontraktues, edhe pasi ky pretendim është ngritur në kërkesën e pare për rishqyrtim, nuk ka bërë asnjë analizë të përmbajtjes së librezës së automjetit, por e ka refuzuar pretendimin pa arsyetuar pse një automjet i regjistruar si **kamion i lehtë** do të konsiderohej si **kamion kiper**, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Një vlerësim i tillë bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe vlerësimit objektiv të provave.

#### **Pretendimi 4: AK ka kërkuar: Cilinder max 5ton:**

Autoriteti Kontraktues ka pranuar si dëshmi për pronësinë e rulit një faturë dhe urdhër-pagesë ndërmjet **HIDRO PROJECT SHPK dhe HIDROING 2 SHPK**. Megjithatë, këto dokumente nuk përbëjnë provë të mjaftueshme mbi prejardhjen ligjore dhe pronësinë e pajisjes.

**Te njejten forme jane sjellur edhe makineria si meposhte:**

**Pllaka vibruese per ngjeshje deri 600 kg,  
Makineri per saldimit ballor te gypave PE deri profilin DN400,  
Aparat per saldim elektrofuzif per gypa PE,**

Te gjitha keto fatura duhet te verifikohen nga ATK per shkak te dyshimit qe jane fatura fiktive nga pamja e sajë qe mungon prejardhja e tyre.

Në rastin konkret mungojnë dokumente që dëshmojnë zinxhirin e pronësisë së makinerisë, si:  
Dokumentacioni doganor i importit (nëse pajisja është importuar);  
Kontrata e shitblerjes ose akti i transferimit të pronësisë;  
Dokumentacioni teknik ose regjistri i asetëve që identifikon pajisjen sipas numrit serik;  
Çdo dokument tjetër që provon se shitësi ka qenë pronar i ligjshëm i pajisjes dhe ka pasur të drejtë ta transferojë atë.

Vetë ekzistenca e një fature dhe një pagese nuk provon automatikisht se operatori ekonomik posedon ligjërisht pajisjen e kërkuar dhe as nuk garanton se pajisja e deklaruar është realisht në dispozicion për realizimin e kontratës, Pra me keto dokumente qe ne posedojme pas qasjes dyshojme qe fatura te jete **FIKTIVE sepse:**

"Nuk është dëshmuar prejardhja ligjore e pajisjes";

"Mungon dokumentacioni që provon zinxhirin e pronësisë"; me nje ne fjale si AK do duheni qe te eliminoni OE ne fjale dhe ne asnje menyre te rekomandohet per kontrate.

Pra si AK keni bere vlersimin totalisht te gabuar dhe keni pranuar si të mjaftueshme dokumente që nuk e dëshmojnë në mënyrë të plotë përmbushjen e kërkesës së dosjes së tenderit.

Kerkojme nga AK qe te kerkoni prejardhjen e kesaj fature ne ATK- Administraten Tatimore te Kosoves. Ne te kunderten nese nuk kerkoni qasjen ne ATK dyshimet per fatur Fiktive jane pothuajse te pa shmangura.

**Pretendimi 5: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum dy kontrata- projekte në ndërtimin e rrjeteve-sistemeve të ujësjellësit gjate 3 vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrat. Në një vlere prej jo me pak se 350,000.0 €. Në rast të Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë projekte të puneve te ujesjellesit te perfunduara gjatë tre viteve të fundit jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.**

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik.

Kërkesa nr. 1 e Dosjes së Tenderit ka qenë e qartë.

**Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka përfunduar me sukses minimum dy kontrata/projekte në ndërtimin e rrjeteve-sistemeve të ujësjellësit gjatë tre viteve të fundit, në vlerë jo më të vogël se 350,000.00 €.**

Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk e ka dëshmuar këtë kërkesë.

Nga lista e kontratave të dorëzuara rezulton se janë paraqitur kontrata me objekte të ndryshme, si:

- Ndërtim kanalizimi;
- Rehabilitim kanalizimi;
- Kyçje individuale;
- Punime të kombinuara ujësjellës-kanalizim.

Megjithatë, Dosja e Tenderit **nuk ka kërkuar përvojë në kanalizim**, por ekskluzivisht në **ndërtimin e rrjeteve-sistemeve të ujësjellësit**.

AK gjatë rivlerësimit ka pranuar kontrata që nuk e përmbushin objektin specifik të kërkuar, duke bërë interpretim të zgjeruar të kriterit, gjë që nuk lejohet pas hapjes së ofertave.

Në praktikën e OSHP-së është parim i konsoliduar se:

- Kriteret e Dosjes së Tenderit duhet të interpretohen në mënyrë strikte;
- Autoriteti Kontraktues nuk mund të zgjerojë ose ndryshojë kriteret gjatë fazës së vlerësimit;
- Një operator ekonomik duhet të përmbushë kriterin pikërisht ashtu si është kërkuar dhe jo në mënyrë të përafërt.

Për më tepër, lista e kontratave nuk përbën në vetvete provë se kontratat e paraqitura janë kontrata për **ndërtimin e rrjeteve të ujësjellësit**, ndërsa një pjesë e tyre kanë objekt krejtësisht tjetër.

Prandaj, Operatori Ekonomik nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës së përcaktuar nga Dosja e Tenderit dhe oferta e tij është dashur të shpallet **e papërgjegjshme**, në përputhje me nenin 70 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për rrjedhojë, rekomandimi për dhënien e kontratës është nxjerrë në kundërshtim me kriteret e tenderit dhe me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

**Kërkojmë që AK ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues, ta shpallë ofertën e OE HIDRO PROJECT SH.P.K. të papërgjegjshme për mosplotësim të kërkesës nr. 1 të kapacitetit teknik dhe profesional.**

AK është mbështetur në **kontratën me Komunën e Prizrenit me vlerë 2.450.000 €**, e cila në titull përmban edhe "ujësjellës". Por jemi shumë skeptik nese certifikata e përfundimit për atë kontratë

tregon se punimet kanë qenë realisht edhe për rrjet të ujësjellësit nga qe mungon deshmia qe I njeiti ka realizuar vertet ujesjelles. (Gjithashtu ne raste te tilla AK do duhet te kerkoje sqarime sa perqind ka realizuar pune Hidro Projekt shpk ne kete kontrate nga qe I njeiti qenka partner I konzorciumit dhe jo lider dhe nga pervoja qe kemi dyshojme qe I njeiti nuk ka te realizuar nje perqindje te madhe te pune dhe nuk e ploteson kushtin siq ka kerkuar AK per kontratat dhe refence per pune te ujesjellsit.

- Për më tepër, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përbën vetëm një shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik dhe të parimeve themelore të trajtimit të barabartë, por prodhon edhe një pasojë të drejtpërdrejtë financiare në dëm të interesit publik dhe buxhetit të Republikës së Kosovës.

Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë ka ofertuar çmimin **229,362.22 €**, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik **Hidro Projekt Sh.P.K.** me çmim **249,951.93 €**, kjo do të thotë se, përmes një vendimi të mbështetur në arsye të pabazuara dhe në interpretime arbitrare të dokumentacionit të ofertës sonë, Autoriteti Kontraktues po favorizon lidhjen e një kontrate me një çmim më të lartë, duke shkaktuar një shpenzim shtesë prej **20,589.71 €** nga fondet publike, pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë përfitim shtesë për autoritetin kontraktues.

Ligji për Prokurimin Publik obligon çdo autoritet kontraktues që, përveç respektimit të parimeve të ligjshmërisë dhe trajtimit të barabartë, të sigurojë edhe përdorimin racional, ekonomik dhe efikas të mjeteve publike. Në rastin konkret, ky obligim është shpërfillur plotësisht. Në vend që të përzgjidhet oferta ekonomikisht më e favorshme dhe e përgjegjshme, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar padrejtësisht Grupin tonë të Operatorëve Ekonomikë mbi arsye të paqëndrueshme dhe ka rekomanduar një ofertë dukshëm më të shtrenjtë, duke cenuar drejtpërdrejt interesin financiar të shtetit.

Ky veprim nuk mund të konsiderohet thjesht një gabim në vlerësim. Kur një operator ekonomik eliminohet në kundërshtim me kriteret e Dosjes së Tenderit dhe si rezultat rekomandohet një ofertë më e shtrenjtë për **20,589.71 €**, atëherë lind dyshimi serioz se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në mënyrë objektive, të paanshme dhe në përputhje me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të korrigjojë këtë shkelje në fazën e rishqyrtimit, pasi në të kundërtën do të mbajë përgjegjësi të plotë ligjore dhe administrative për pasojat që ky vendim i kundërligjshëm i shkakton buxhetit të Republikës së Kosovës. Nëse kjo shkelje nuk korrigjohet, do të kërkojmë që çështja të shqyrtohet nga organet kompetente, përfshirë edhe aspektin e përgjegjësisë për shkaktimin e një dëmi të pajustificueshëm ndaj fondeve publike, si pasojë e eliminimit arbitrar të ofertës sonë dhe favorizimit të një oferte me çmim më të lartë.

Kerkojme qe ju si OSHP te nxjerrni kete:

## VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa GOE "KUSHTRIMI NM" SH.P.K, "COMPANY MURSELI" SH.P.K. & "ALPING" SH.P.K"

**ANULOHET**, vendimi i AK-së- dhe lënda te kthehet ne rivlerësim

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkëlja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

|                                                                           |
|---------------------------------------------------------------------------|
| Demet e shkatuara ne rast te humjes se ketij tenderit jane = 175,000.00 € |
|---------------------------------------------------------------------------|

### 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*